



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA FERIZAJ

Për Aktivitetin e Prokurimit: 656-20-138-211; 656-20-6690-2-1-1

Sa i përket tenderit Shtruarja e rrugëve me zhavor - hapja e rrugëve të reja dhe rregullimi i rrugëve të arave me zhavor - projekt tre vjeçar

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Rahovica Comerce SHPK" SHPK - Ferizaj

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ferizaj

(Adresa) *Ferizaj*

70 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049/120-969

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Fehmi Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

f.rahovica@hotmail.com

(Adresa elektronike)

04.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë " apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Shpallja e procedurës në e-prokurim (27.10.2020)

Kërkesa për sqarime në AK:

Nuk kemi pranuar asnjë përgjigje sqaruese nga AK-ja

Refuzimi i Kërkesës për sqarim DT 03.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>					Jo	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	--	--	--	--	----	--------------------------

--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shitesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	----	--------------------------	--------------------------

Vendimi i AK – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 108/A

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga AK:
<p>Sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042</p> <p>Neni 1 i LPP – Qellimi i ligjit;</p> <p>Neni 7 i LPP – Barazia në trajtim/jo-diskriminimi</p> <p>Neni 69.8 i LPP – Kapaciteti financiar</p> <p>Neni 18.3 i RRUOPP-se;</p> <p>Neni 19.2 i RRUOPP-se;</p> <p>Neni 18.9 i RRUOPP-se;</p> <p>Neni 28 i LPP-se - Specifikimet teknike</p> <p>Neni 44 i LPP-se – Rregullat për shkurtimin e afateve kohore;</p> <p>Neni 46 i LPP-se – Shkurtimi i afateve kohore;</p>
Neni 51 i LPP – Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Lidhur me Aktivitetin e prokurimit “Shtruarja e rrugeve me zhavor - hapja e rrugeve të reja dhe rregullimi i rrugeve të arave me zhavor - projekt tre vjeçar”, me nr.prok. 656-20-6690-2-1-1.

AK – Komuna Ferizaj në tenderin e shpallur ka përdorur kriteret/kerkesat diskriminuese duke shkelur nenin 1 të LPP-se, Nenin 6 të LPP-se, Nenin 7 të LPP-se, Nenin 18.9 të RRUOPP-se, Nenin 18.13 të RRUOPP-se, Nenin 19.2 të RRUOPP-se.

Te aneksi 1 Specifikimet e detyrueshme - Lista e pajisjeve AK ka perdorur kriteret diskriminuese ku jane disa pajisje qe nuk jane te nevojshme per ekzekutimin e projektit .

Ne si AK i kemi kerkuar kerkuar sqarime AK-se per kriteret e perzgjedhjes te cilat jane te vendosura nga AK, por pergjigjen e kemi pranuar vetem pasi kemi parashtruar Kerkesen per ri shqyrtim

AK na eshte pergjigjur se

ARSYETIM

Pas shqyrtimit te kerkeses per sqarim te DT nga ana juaj, ne si Autoritet Kontraktues konstatojme se nuk pajtohem me kerkesat e juaja per ndryshimin e kushteve te DT per te cilat ju beni krahasime me kushtet e tenderimit te viteve te kaluara. Kushtet e tenderit jan hartuar duke u bazuar ne specifikat,rendesine dhe vleren e parashikuar te ketij tenderi dhe dihet se tenderi actual eshte tender me vlere te madhe krahasuar me tenderet e viteve te kaluara ku te drejte konkurimi kane edhe kompanite nderkombetare.

Ne si OE ju sqarojme se kemi pasur Shtruarjen e rrugeve me zhavor per afro 10 vite dhe vlere e kontratave kap shifren mbi 1 milion euro dhe nuk kan qene keto kriteret po ashtu ne kemi kontrata edhe me te medha me te njejtin Autoritet Kontraktues dhe nuk kan qene keto kriteret diskriminuese.

Kriteret diskriminuese qe ka bere AK duke shkelur nenin 7 te LPP-së, me qellim te favorizimit te nje operatori dhe diskriminimit operatorëve tjere,

AK Kriteret te cilat ne si AK i kemi kerkuar sqarime AK-Komuna Ferizaj jane te paraqitura si ne vijim:

Menaxher i projektit -- 1.Inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - konstruktiv me 5 vite pervojë pune pas diplomimit i qertifikuar ne AME (Agjensionin per menagjimin e emergjencave) dhe te kete trajnim ne sistemin e shendetit dhe siguris ne pune

Kriteri I kerkuar eshte diskriminues pasi qe inxhinieri I ndertimtarise -- konstruktiv me 5 vite pervojë pune pas diplomimit i qertifikuar ne AME dhe te kete trajnim ne sistem te shendetit dhe sigurise ne pune sepse natyra e punes nuk eshte te kete kualifikim te natyres se tille sepse ka persona tjeter te certifikuar me AME, por jo edhe inxhinieri te jete me kete certificate sepse kjo bie ndesh me nenin 7 te LPP-se.

Kerkojme qe te hiqet kriteri I qertifikuar ne AME dhe te kete trajnim ne sistemin e shendetit dhe sigurise ne pune.

5.Lista e mjeteve te punës,

1. Eskavator me kapacitet 45-48t min.1 cope

Pajisjet e kerkuara nga AK jane diskriminuese ndaj shume Operatorëve dhe favorizuese per nje operator sepse per projektin "Mirembajtja e e

2. Eskavator me kapacitet 24-26t min.2 copë	rrugeve nuk ka nevojë të mirembahen me pajisjet ashtu siç i ka kërkuar AK-ja.
3. Eskavator me kapacitet 16-20t min 4 copë	Pra, kjo bie ndesh me nenin 7 të LPP-se Barazia në trajtim dhe jo diskriminimi, sepse AK mund të kërkon pajisjet e mjaftueshme për ekzekutimin e punimeve që AK të kërkon me kriterin MINIMUM,
3. Eskavator me kapacitet 7-10t min 1 copë	Psh, Eskavator min.25 ton,
4. Eskavator me kapacitet 3-5t min 2 copë	Ngjeshes min.9 ton; lopatë ngarkuese 65-70 ton, është shumë e paqarte sepse ky kriter ska kuptim për arsye se nuk është duke u hapur rrugë e re apo ndonjë autostradë, por natyra e projektit është shërbim. Haptaz shihet kriteri diskriminues(lidhur me lopatën ngarkuese 65-70 ton, është e pakuptimte sepse në Kosovë nuk gjenden eskavator 65-70 ton, e lere lopatë ngarkuese që e keni kërkuar ju).
5. Greder rrafshues min 2 cope	Kjo është në kundërshtim edhe me ligjet e komunikacionit në Kosovë për shkak se policia e Kosovës nuk e lejon në rrugë peshën mbi 41 ton për shkak se kjo peshë duhet të nxirret leje speciale nga departamenti i rrugëve dhe policia e Kosovës që të jetë nën përcjellje transportimi i kësaj makinerie, po ashtu vlen të ceket se për të transportuar këto ngarkues duhet të jetë i demoluar sepse nuk ekziston rimorkio 65 ton për të transportuar.
6. Ngjeshes cilindër min 2 cope	Te gjitha kriteret AK i ka me peshë të lartë që nga përvojat e mëherëshme në e kemi pasur mirëmbajtjen e rrugëve prej afro 10 viteve dhe asnjëri nga këto mjete nuk kanë pasur nevojë të futen në punë, vetëm se mirëmbajtja është bërë me : Greder, cilindër, dhe kamiona.
7.Lopatë ngarkuese me kapacitet 65-70 t min 1 cope	Pra, vlen për të theksuar se në vitet e kaluara ska patur fare kritere.
8. Kamion kiper mbi 10t min 7 copë	Kërkojmë që të hiqen kriteret diskriminuese dhe të vendosen kriteret e mëherëshme sepse kjo e
9. Rimorkio me peshë bartese mbi 45t	
10. Çekan hidraulik që vendoset në eskavator 1 cope	
11. Bulduzher min 1 cope	

<p>Nje person i trajnuar per instalimin e gypave</p>	<p>redukon konkurrencen dhe komuna do te kete kosto me te madhe per mirembajtje!</p> <p>Pyetja</p> <p>Nuk e dije se per cfare kerkohet ky kriter pasi qe nuk ka nevojte te instalohen gypa sepse nuk eshte duke u kryer ndonje projekt ujesjelli apo kanalizimi, qe te kete OE person te trajnuam per Instalim te gypave.</p> <p>Kerkojme qe te hiqet ky kriter.</p>
<p>Nje person me pergaditje superiore (fakultet) per LEAD AUDITOR per ISO 14001 2015</p>	<p>Pyetja</p> <p>Cfare nevojte ka ky person me pergatitje superior sepse nuk po dihet qellimi a eshte te mbahen trajnime per ISO standard apo po qellimi eshte mirembajtje e rugeve.</p> <p>Te hiqet ky kriter sepse haptaz shihet diskriminimi qe ben AK ndaj OE-ve vetem per te favorizuar nje OE te preferuar.</p>
<p>Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se ka staf minimum 30 punetore dhe 5 puntor per mbrojtje nga zjarri .</p>	<p>Pyetja</p> <p>Edhe ky kriter si kriteret e meparshme, sepse nuk eshte projekte per shuarje te zjarreve, por mirembajtje e rugeve.</p> <p>Te hiqet ky kriter diskriminues per cfare e ka pergatitur AK-ja, dhe te vendoset kriter psh. I trajnuar per shendet dhe siguri ne pune, e jo punetor per mbrojtje nga zjarri sepse nuk eshte projekt i zjarrfikjes qe te kerkohet.</p>
<p>Te gjitha kriteret e paraqitura si me larte si per menaxherin e projektit shihet haptaz se eshte kriter diskriminues ndaj OE-ve sepse te kriteri Lista e pajisjeve/mjeteve te punes, Stafit, certifikatave ISO, etj.</p> <p>AK ka shkurtuar afatin kohor per hapjen e ofertave.</p> <p>Duke perdorur kriteret diskriminuese AK ka shkelur nenin 1 te LPP-se (qellimi) :</p>	

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

AK ka shkelur, poashtu edhe nenin 6 (ekonomiciteti dhe efikasiteti) të LPP-se:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

AK ka shkelur nenin 7 (barazia në trajtim/jo diskriminimi) të LPP-se (citim):

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

AK me keto kritere diskriminuese ka shkelur nenin 69.8 (Aftësitë teknike dhe/ose profesionale) të LPP-se:

8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera.

Pra, sipas këtij neni thuhet se OE të mbështeten me mjete edhe nga OE të tjera

Neni 18.9 i RrUOPP-se thotë:

Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë Operatoreve Ekonomik.

Neni 18.13 i RrUOPP-se thotë:

Eshte e ndaluar pergatitja e dosjes se tenderit ne nje menyre qe favorizon ose diskriminon kunder nje ose me shume se nje Operator Ekonomik potencial.

Neni 19.2 i RrUOPP-se thote:

...Gjithashtu AK duhet te percaktojne ne dosjen e tenderit kriteret objektive dhe jo diskriminuese apo rregullat per shperblimin e llojeve te ndryshme.

Neni 51.3. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Poashtu AK shkelur edhe nenin 28 te LPP-se, Specifikimet teknike, per shkak se sasite jane aq te medha sa qe jane te pabesueshme te realizohet e gjithë ajo sasi e kerkuar, pra dyshojme se jane sasi te fryera, dhe kerkojme nga AK qe te na lejohet OE-ve qe te merren projektet per analizim dhe te vertetohet sasia e vendosur ne paramase.

Pra me kete AK ka shkelur nenin 28 te LPP-se, qe thote:

Neni 28 – Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.

2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera.

AK-Komuna Ferizaj ka shpallur tenderin me vlere te madhe pune e cila shpallur me dt. **21.10.2020**, por AK e ka caktuar daten e hapjes **09.11.2020 ora 12:00..**

Si eshte e mundur te behet hapja e ofertave, ku gjer me tani, ku AK ska dhane asnje pergjigje ndaj OE-ve te interesuar, bazuar ne sqarimet e kerkuara nga OE te interesuar. Pra. Obligim i AK eshte ti

respektoj ligjet ne fuqi dhe LPP-se qe duhet tu kthen pergjigje OE-ve per cdo sqarim qe u kerkohet nga OE-te.

Pra, AK duhet ta respektoj ligjin.

Te gjitha kriteret qe i kemi paraqitur jane diskriminuese dhe kjo ka per qellim favorizimin e nje operatori dhe diskriminimin e shume OE-ve sic e percakton edhe neni 7 i LPP-se.

Si Prove i gjeni kriteret qe i keni perdorur ju si AK ne vitin 2018 dhe 2019.

Kriteret diskriminuese te cilat i ka perdor AK-ja,

Kërkojmë nga AK-Komuna e Ferizajt qe te merr :

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "Rahovica Commerce" SHPK - Ferizaj

DETYROHET, autoriteti kontraktues qe te beje terheqjen e kriterëve diskriminuese dhe te vendos kriterë te matshme.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Demet e shkaktuara ne kete procedure prokurimi janë 1,500 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.